



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:035829  
Datë: 09.10.2024  
Numri i dokumentit: 06276615

C.nr.597/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Diora Bajrami, me praktikanten Dafina Osmanollaj duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve B.K.S., dhe H.S. nga Prizreni të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokat B.J. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria për Arsim, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 1,000.00 euro, jashtë seance, me datë 09.10.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht bazuar kërkesëpadia e paditëseve B.K.S. dhe H.S. nga Prizreni DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit- Drejtoria për Arsim, që paditëses të kompensohet në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:
  1. Paditësit B.K.S. për periudhën kohore 01.10.2021 - 21.11.2022, në shumën prej 565.55 euro me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (31.01.2024), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.
  2. Paditësit H.S. për periudhën kohore 01.10.2021 – 21.11.2022, në shumën prej 565.55 euro me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (31.01.2024), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.
- II. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit përkatësisht për secilën paditëse u refuzua shuma prej 157.75 euro, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit.
- III. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit- Drejtoria për Arsim, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 176.00 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditëset B.K.S., dhe H.S. nga Prizreni në këtë gjykatë me datë 31.01.2022, përmes të autorizuarit të tyre B.J. nga Prizreni kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria për Arsim, për shkak të kompensimit të inflacionit në pagë.

Në padi ka theksuar se paditëset janë punëtores e arsimit në SHFMU “Naim Frashëri” në fshatin Kobaj – Prizren, paditësja B.K.S. ka filluar punën pranë të paditurës me datën 05.10.2021 dhe realizon pagën bazë neto 524.81 euro, ndërsa paditësja H.S. ka filluar punën pranë të paditurës me datën 19.10.2021 dhe realizon pagën bazë neto 524.81 euro. dhe bazuar në nenin 35 par.10, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësit vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar, ashtu që paditëses Besmire Krasniqi Sedolli për periudhën kohore 01.10.2022- 20.11.2022 ti paguhet shuma prej 723.30 euro dhe për paditësen Hava Sinani shumën prej 723.30 euro. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 18.05.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditëses nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësve se i takojnë beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpapia e paditëses është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e Punës me nr. protokolli 114/2021 të datës 05.10.2021 për paditësen B.K.S. e lëshuar nga e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësja B.K.S. është në marrëdhënie pune tek SHFMU “Naim Frashëri” në fshatin Kobaj, si mësimdhënëse e biologjisë, që nga viti 2021, ndërsa paga bazë sipas listës së pagave të bashkangjitura në padi nr.10-93281-622-0912 është 588 euro.

Ndërsa për paditësen H.S. gjykata ka gjetur se nga Kontrata e Punës me nr.protokollit 116/2021 të datës 19.10.2021 e lëshuar nga e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësja B.K.S. është në marrëdhënie pune tek SHFMU “Naim Frashëri” në fshatin Vlashnje si mësimdhënëse e teknologjisë, që nga viti 2021, ndërsa paga bazë sipas listës së pagave të bashkangjitur në padi nr.10-93281-622-0912 është 588 euro.

Po ashtu, nga njoftimit i MASHT-it të datës 11.12.2023 vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëseve është shuma prej 421.00 euro. Po ashtu, gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve” ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

Për paditësen B.K.S. dhe paditësen H.S.

- Për periudhën 01.10.2021 – 21.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 42.93 euro ( $421 * 3.4\% = 14.31 * 3 = 42.93$  euro).
- Për periudhën 01.01.2022 – 21.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, andaj duke pasur parasysh kërkesën e paditësit dhe se paga bazë e paditëseve në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 522.62 euro ( $421 * 11.6\% = 48.83 * 10 = 488.6$  si dhe periudha 21 ditë të muajit Nëntor është 34.02 sipas llogaritjes ( $48.83 / 30 = 1.62 * 21$  ditë = 34.02) =  $488.6 + 34.02 = 522.62$  euro).
- Apo secilës paditëse veç e veç i takon shuma prej 565.55 euro për periudhën kohore nga data 01.10.2021 e deri me dt. 21.12.2021.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata vendosi duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, andaj ka vendosur si në pikën nën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese si në pikën nën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*.

Gjithashtu, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ia njohur paditësve kompensimin mbi bazën e përqindjes së inflacionit në pagën bazë të cilën e realizon paditëset dhe atë në shumën prej 421.00 euro, duke u bazuar në njoftimin e MASHT-it të datës 11.12.2023, ku vërtetohet lartësia e pagës bazë e paditëseve, e që është shuma prej 421.00 euro dhe jo siç është kërkuar nga paditëset në shumën prej 524.81 euro, pasi që këtë pagë paditëset e kanë realizuar në vitin 2023 ashtu siç u vërtetua nga lista e pagave nr.10-93277-622-0912 (për vitin 2023) është në shumën prej 588 euro.

Gjykata po ashtu e refuzoi si të pabazuar kërkesën e paditëseve nga data 21.11.2022, deri me datë 31.12.2022, kjo pasi që bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme me numër GJ.A-Su.A 214/2023, të datës 09.10.2023, në pikën III, është përcaktuar se: Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e lidhur me datë 22.01.2021, aplikohet në periudhën kohore nga data 22.01.2021, e deri në datën 21.11.2022. Andaj, mbi këtë bazë, gjykata refuzoi të pabazuar kërkesën e paditëseve sikurse në pikën nën III. të dispozitivit të aktgjykimin dhe atë duke ia refuzuar pjesën e kërkesës për periudhën 22.11.2022-.31.12.2022 si dhe duke e minusuar shumën e kërkuar në raport me pagën bazë të kërkuar nga paditëset e në shumë prej 524.81 euro dhe asaj që paditëset e realizojnë e që është në shumë prej 421.00 euro, pra shuma e tërësishme e pabazuar për secilën paditëse veç e veç është në lartësi prej 157.75 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (31.01.2024), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 156.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 176.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

Numri i lëndës: 2024:035829  
Datë: 09.10.2024  
Numri i dokumentit: 06276615

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL  
C.nr.597 /2024, datë 09.10.2024

G j y q t a r j a

Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimet pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.